PROÇESVERBAL

Nga seanca e këshillit të mbajtur me 28.02.2023, e martë me fillim në ora 10:00, në sallën e këshillit të komunës së Zhelinës, në prezencë të këshilltarëve .

Seancën e 16-të(gjashtëmbëdhjetë) e hapi Kryetari i këshillit Bujar Baftijari, dhe prezantoi rendin e ditës, që përbëhet nga 8 pika.

REND DITE

1. Miratimi i proçesverbalit të seancës së 15-të, (pesmbëdhjetë), të Këshillit të komunës së Zhelinës.
2. Propozim-Vendim për miratimin e propozimit për themelimin e trupit të përbashkët administrativ ndërkomunal për mbikqyrje administrative në mjedisin jetësor në Rajonin planor të Pollogut.
3. Propozim-Vendim për ndryshimin e Vendimit për realizimin e Buxhetit të komunës së Zheinës për vitin 2023-të.
4. Miratimi i Raportit financiar kuartal për realizimin e Buxhetit të komunës së Zhelinës për periudhën prej 01.01.2022-të deri më 30.09.2022-të.
5. Miratimi i Raportit financiar kuartal për realizimin e Buxhetit të komunës së Zhelinës për periudhën prej 01.01.2022-të deri më 31.12.2022-të.
6. Propozim-Vendim për dhënie Pëlqim të Planit financiar të Ndërmarjes publike komunale „Mirëmbajtja'' – Zhelinë, f.Zhelinë për vitin 2023-të.
7. Propozim-Vendim për mbartjen e kompetencave dhe përgjegjësive për ekonomizimin me rrjetin e ujësjellësit Shoqatës së qytetarëve Llukojca – f. Llukovicë – komuna e Zhelinës.
8. Shqyrtimi i Kërkesës nr.08-297/1 i datës 23.02.2023-të, nga Bashkësia lokale e f.Stremnicë, si dhe Shqyrtimi i Kërkesës nr.21-256/1 i datës 16.02.2023-të, nga Naxhije Rexhepi nga f.Trebosh.

Kryetari i këshillit Bujar Baftjari hapi diskutim për rendin e ditës. Fjalën e kërkoi këshilltari Naser Mislimi.

Naser M: Kërkoj që në shqyrtimin e kërkesave të shtohet edhe një kërkesë nga Bashkësia Lokale e fshatit Strimnicë me nr. Arkivor 09-298/1 e datës 23.02.2023 –Vendosja e pllakatës përkujtimore.

Kërkesa e Këshilltarit Naser u hodh në votim dhe u votua unanimisht.

Pas kësaj Kryetari i këshillit e hodhi në votim rendin e ditës, u votua unanimisht.

Kryetari i këshillit e shpalli të hapur senacën e 16-të.

1. Miratimi i proçesverbalit të seancës së 15-të, (pesmbëdhjetë), të Këshillit të komunës së Zhelinës.

Kryetari i këshillit hapi diskutim për pikën e parë, meqë nuk pati diskutim këtë pikë e hodhi në votim, ku u votua unanimisht.

2. Propozim-Vendim për miratimin e propozimit për themelimin e trupit të përbashkët administrativ ndërkomunal për mbikqyrje administrative në mjedisin jetësor në Rajonin planor të Pollogut.

Kryetari i këshillit dha sqarime pak sa i përketë kësaj pike. Më pas hapi diskutim, fjalën e kërkoi këshilltari Sheval Sulejmani.

Sheval S: Kërkoj informacione më të detajuara rreth kësaj çështje, pra ta dimë e ja vlen të formohet ky trup ose jo.

Detaje e hollësishme i dha Sedat Rushani Inspektor komunal.

Pas disktimit Kryetari i këshillit këtë pikë e hodhi në votim, ku me 11 vota pro, asnjë kundër dhe 8 të përmbajtur, konsatoi se kalon.

3. Propozim-Vendim për ndryshimin e Vendimit për realizimin e Buxhetit të komunës së Zhelinës për vitin 2023-të.

Kryetari i këshillit dha sqarime se bëhet fjalë për te neni 8 pika 1 duhet të fshihen fjalët TPPE si dhe neni 14, pika 2 duhet të zëvendësohet me i punësuari ka të drejtë me regres të pushimit vjetor në lartësi prej më së paku 9000 den NETO, me kusht që i punësuari të ketë punuar më së paku 6 muaj sipas kalendarit akademik te punëdhënësi.
Më pas hapi diskutim, fjalën e kërkoi këshilltari Naser Mislimi.
Naser M: Çfarë është TPPE, dhe a ka mjete për këto pagesa?
Adil Emini nga sektori për financa dha sqarime për këtë.
Këtë pikë Krytari i këshillit e hodhi në votim, ku me 10 vota të përmbajtur, asnjë kundër dhe 9 vota pro, konsatoi që kjo pike nuk kalon.

4. Miratimi i Raportit financiar kuartal për realizimin e Buxhetit të komunës së Zhelinës për periudhën prej 01.01.2022-të deri më 30.09.2022-të.

Kryetrai i këshillit hapi diskutim fjalën e mori këshilltari Sheval Sulejmani.

Sheval S: Një sqarim të shkurt te 421 të dalurat operative, çfarë janë këto shuma pse janë të paraqitura?

Adil E: Dha sqarime.

Kryetari i këshillit këtë pikë e hodhi në votim, ku me 11 vota pro, 8 të përmbajtur dhe asnjë kundër konstatoi se kjo pikë kalon.

5. Miratimi i Raportit financiar kuartal për realizimin e Buxhetit të komunës së Zhelinës për periudhën prej 01.01.2022-të deri më 31.12.2022-të.

Meqë nuk pati diskutim për këtë pikë, Kryetari i këshillit e hodhi në votim, ku me 11 vota pro, 8 të përmbajtur dhe asnjë kundër konstatoi se kjo pikë kalon.

6. Propozim-Vendim për dhënie Pëlqim të Planit financiar të Ndërmarjes publike komunale „Mirëmbajtja'' – Zhelinë, f.Zhelinë për vitin 2023-të.

   Meqë nuk pati diskutim për këtë pikë, Kryetari i këshillit e hodhi në votim, ku me 8 vota pro, 11 të përmbajtur dhe asnjë kundër konstatoi se kjo pikë nuk kalon.

7. Propozim-Vendim për mbartjen e kompetencave dhe përgjegjësive për ekonomizimin me rrjetin e ujësjellësit Shoqatës së qytetarëve Llukojca – f. Llukovicë – komuna e Zhelinës.

   Kryetari i këshillit për këtë pike i informoi këshilltarët që detajet e hollësishme do t'I jep kryetari i shoqatës së qytetarëve Llukojca.
   Pas sqarimeve këtë pike e hodhi në votim ku me 1 votë për, asnjë kundër dhe 18 të përmbajtur konstatoi që kjo pike nuk kalon.

8. Shqyrtimi i Kërkesës nr.08-297/1 i datës 23.02.2023-të, nga Bashkësia lokale e f.Stremnicë, si dhe Shqyrtimi i Kërkesës nr.21-256/1 i datës 16.02.2023-të, nga Naxhije Rexhepi nga f.Trebosh.

Kryetari i këshillit hapi diskutim, fjalën e mori këshilltari Naser Mislimi.

Naser M: Për këtë kërkesë jam i informuar i di të dy projektet, unë jam i mendimit që vetëm projekti që vinë nga shkolla konkretisht me nënshkrim të drejtorit të kaloj, dhe për këtë kërkesë kam edhe një kundër ankesë që e ka bërë një pjesë e bashkësis lolake.

Pas këshilltarit Naser M. Fjalën e mori këshilltari Nderim Tairi.

Nderim T: Mendoj që këto dy kërkesat e fshatit Strimnicë të shtyhen për séance e ardhshme, që edhe ne t'i shohim projektet për çka bëhet fjalë konkretisht.

Kryetari i këshillit pas diskutimeve kërkesën e hodhi në votim, ku me 19 të përmbajtur kjo kërkesë nuk kaloi.

Kryetari i këshillit prezantoi kërkesën e radhës me nr. Arkivor 21-256/1 nga Naxhije Rexhepi nga fshati Trebosh, që kërkonte dëmshbërblim ngase ishte sulmuar nga një qen endacak.

Pas prezantimit fjalën e mori këshilltari Nderim Tairi.

Nderim T: E kemi pas edhe një rast të ngjashëm si ky, mendoj se duhet e njëjeta shumë si në rastin e ngjashëm të kaluar t'i ndahet edhe kësaj kërkese.

Pas këshilltarit Nderim T. fjalën e mori këshilltarja Elmedina Zeqiri.

Elmedina Z: Unë propozoj që për të tilla raste komuna të formoj komision për vlerësimin e këtyre çështjeve.

Pas këshilltares Elmedina Z. Fjalën e mori këshilltari Rian Amiti.

Rian M: Propozoj si dëmshpërblim këtij rasti t'i ndahen 10 000 den.

Propozimin e këshilltarit Rian A. Kryetari i këshillit e hodhi në votim ku me 4 vota të përmbajtur, 15 për dhe asnjë kundër konstatoi se kjo kërkesë kalon.

Kryetari i këshillit prezantoi edhe kërkesën e tretë me nr. Arkivor 09-2981/1 vendosja e pllakatës përkujtimore në f. Strimnicë.

Pas prezantimit meqë nuk pati diskutim Kryetari i këshillit kërkesën e hodhi në votim ku me 2 vota të përmbajtura, 17 pro dhe asnjë kundër konstatoi se kjo kërkesë kalon.

Kryetari i këshillit Bujar Baftijari e konstatoi të mbyllur seancën e gjashtëmbëdhjetë.

Nr . 08-292/2
28.02.2023-të
Zhelinë

Procesvebalist
Albineta Alija

Këshilli i komunës së Zhelinës
Kryetar
Bujar Baftijari